



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:274374

Datë: 16.12.2024

Numri i dokumentit: 06607018

C.nr.1150/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve: I.V nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, K.S nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, N.B nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, H.K nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, dhe D.B, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. A.M nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seancës, me datë 26.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësve: I.V nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, K.S nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, N.B nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, H.K nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, dhe D.B, ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, në çështjen juridike kontestimore C.nr.1150/2024.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit I.V nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, K.S nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, N.B nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, H.K nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, dhe D.B, pranë kësaj gjykate me datë 18.09.2024, përmes përfaqësuesve të autorizuar Av. A.M nga Rahoveci, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike - kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit e pa përcaktuar.

Kjo gjykatë me Aktvendimin C.nr.1150/2024 të datës 26.11.2024, i ka ftuar paditësit që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh ta paguajnë taksën gjyqësore për padi, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguajnë do të konsiderohet se e kanë tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, me datën 29.10.2024, e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës së kërkuar për padinë.

Sipas nenit 253 paragraf. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësit nuk e kanë bërë pagesën e taksës për padi brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga pagesa e të njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 253 paragraf. 5 lidhur me nenin 387 paragraf. 1 pika c) të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,
C.nr.1150/2024, me datë 26.11.2024.

B. profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.